



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Datë: 16.11.2016

Deçan

Në bazë nenit 11 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149, nenit 62.3 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dhe nenit 18, pika 18.3 të Statutit të QKMF-ës, Kryetari i Komunës së Deçanit, shpall:

K O N K U R S

(Drejtor i Qendres Kryesore të Mjekësisë Familjare “Adem Ukehaxhaj” Deçan)

Për vendin e punës:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Deçan

I. Vendi i punës: **Drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Deçan**

Numri i ekzekutuesve: një (1).

Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë në punë dhe afarizmin e QKMF-së në punët profesionale të QKMF-së e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e ligjit, statutit dhe akteve tjera nënligjore;

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi:

- Në pajtim me politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Republikës së Kosovës dhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor, drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, planin e punës për buxhetin e QKMF-së për vitin vijues;
- Është përgjegjës për zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
- Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale zbaton buxhetin e QKMF-së;
- Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF;
- Zhvillon marrëdhënie të mira me donatorët, OJQ-të dhe me partnerët për zbatimin e tyre;
- Mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së;
- Për punën e tij i raporton Drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;

Kualifikimi profesional, aftësitë .

- Doktor Specialist
- Licenca e punës
- Pesë(5) vite përvojë pune në shëndetësi
- Certifikata mjekësore CM 0102

Kushtet e dëshiruara

- Përvoja në leminë e shëndetësisë;
- Trajnimet në menaxhmentin shëndetësor dhe shëndetësi publike

Periudha e kontratës:

- Kater (4) vit punë me mundësi vazhdimi.
- Paga: Koeficienti 12

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Diploma mbi kualifikimin (e vërtetuar)
- Certifikata e lindjes
- Kopja e letërnjoftimit
- Deshmi mbi pervojën e punës
- Certifikata që dëshmojnë njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera.

-Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes nga data: 16-11-2016 deri 30-11-2016.

Aplikacionet merren në Zyrën pritese në Objektin e komunes së Deçanit dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pritese. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën shëndetësore, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet, të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.